



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Digital Port” (*Procedure e hapur - Mall*)

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,900,000 (Katërmëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë, pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Platforma kompjuterike 30211300-4
- Sistem elektronik i inteligjencës 35721000-4
- Sistem kontrolli kompjuterik 48151000-1

Afati i zbatimit do të jetë **4 (katër) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet. në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/b dhe neni 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % nga vlera e përlogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 4 dhe neni 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të

jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së të ndryshuar, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat perkatese të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuara) të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë.

- a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, për menaxhimin e cilësive, që ka lidhje me objektin e prokurimit.
- b) **ISO 27001:2022 ose ekuivalente**, për menaxhimin e sigurisë së informacionit, që ka lidhje me objektin e prokurimit.
- c) **ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente**, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Duke qenë se projekti pjesë e prokurimit është i rëndësishëm për sigurinë dhe vijueshmërinë e punës të sistemeve kritike në APD duhet që subjektet zbatuese të kontratës të jenë të pajisura me këto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përbushja e standartit **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

- Përbushja e standartit **ISO 27001:2022 ose ekuivalent** është i rëndësishëm për të siguruar që shoqëritë zotërojnë njohuritë si dhe procedurat e menaxhimit të sigurisë së informacionit që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të

implementuar një sistem menaxhimi të sigurse për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të sigurse.

- Përmbushja e standartit **20000-1:2018 ose ekuivalent** është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin profesional dhe të standardizuar të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Ky certifikim garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem të menaxhimit të shërbimeve IT në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke siguruar cilësi, siguri dhe vazhdimësi operacionale gjatë zbatimit të kontratës dhe mirëmbajtjes së sistemeve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatimeve taksive. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa për të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim të shërbimeve të teknologjisë së informacionit ITIL ose ekuivalent është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik të zotërojë njohuritë dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në administrimin, ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve IT.

Në kuadër të projektit “Digital Port”, menaxhimi korrekt i shërbimeve IT është thelbësor për garantimin e vazhdimësisë së komunikimeve, standardizimin e proceseve, menaxhimin e incidenteve dhe rritjen e efikasitetit operacional.

Një specialist i certifikuar ITIL ose ekuivalent, siguron që proceset e shërbimeve të teknologjisë së informacionit të jenë të dokumentuara, të kontrolluara dhe të përmirësohen vazhdimisht sipas praktikave të standardizuara, duke reduktuar rreziqet dhe ndërprerjet në funksionimin e sistemit të telefonisë.

Ky kriter është proporcional dhe në përputhje me natyrën e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve që do të ofrohen.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I

ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhim projektesh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në menaxhimin e projekteve është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik zotëron kapacitetet profesionale për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin në mënyrë të strukturuar të projektit “Digital Port”.

Ky projekt përfshin ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese të komunikimit të Autoritetit, integrimi me sistemet aktuale dhe migrim konfigurimesh të ndjeshme, që kërkojnë ndjekje sipas metodologjive të standardizuara të menaxhimit të projekteve (p.sh. PMI, PRINCE2, IPMA).

Prania e një specialisti të certifikuar siguron përdorimin e praktikave të mira për menaxhimin e afateve, burimeve dhe rreziqeve teknike, duke garantuar përfundimin me sukses dhe brenda standardeve të cilësisë të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për sisteme operative për servera (Windows Server, Linux) në të cilin do të instalohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Kërkesa për të paktën një specialist të certifikuar në sisteme operative serverash (Windows Server ose Linux) përbën një kriter teknik minimal dhe të domosdoshëm për garantimin e funksionimit të sigurt të projektit të Portit Digjital.

Duke qenë se platforma do instalohet dhe operoj mbi një mjedis serverash enterprise, konfigurimi i pasaktë ose administrimi nga personel jo i kualifikuar mund të shkaktojë probleme të rënda operacionale, ndërprerje të shërbimeve, vulnerabilitete të sigurisë dhe rrezik për integritetin e të dhënave.

Certifikimet zyrtare si MCSA/MCSE, RHCSA/RHCE, CompTIA Linux+, apo ekuivalente të njohura ndërkombëtarisht, sigurojnë që specialisti zotëron njohuritë e standardizuara dhe kompetencat e nevojshme për instalimin, konfigurimin, hardening, monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së serverëve.

Për këtë arsye, kriteri është i arsyeshëm, proporcional dhe në përputhje me praktikat më të mira për projekte të rëndësishme kritike, duke garantuar stabilitet, siguri dhe vazhdimësi të shërbimit të platformës së Portit Digjital.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për baza të dhënash me të cilën do të ndërtohet databaza e platformës të Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatimeve. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Baza e të dhënave do të përfaqësojë komponentin më kritik të platformës së Portit Digjital, pasi në do të ruhen dhe përpunohen të gjitha informacionet operacionale, transaksionale dhe administrative të portit. Për të garantuar funksionim të pandërprerë, siguri të lartë dhe performancë optimale, kërkohet që operatori ekonomik të ketë të paktën një specialist të certifikuar për bazën e të dhënave mbi të cilën do të ndërtohet sistemi, ose certifikim ekuivalent. Certifikimi i këtij specialisti është i domosdoshëm,

sepse vetëm një profesionist me njohuri të vërtetuara mund të projektojë arkitekturën e duhur të databazës, të përcaktojë struktura dhe marrëdhënie të sakta të të dhënave dhe të realizojë konfigurime që sigurojnë kohë minimale përgjigjeje edhe në kushte ngarkese të lartë.

Një specialist i certifikuar garanton zbatimin e praktikave më të mira në fushën e sigurisë së informacionit, përfshirë kontrollin e aksesit, enkriptimin, auditimin dhe administrimin e privilegjeve, duke mbrojtur kështu integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave. Ai është në gjendje të aplikojë teknika të avancuara optimizimi, të menaxhojë query-t në mënyrë efikase dhe të ndërtojë mekanizma të besueshëm për backup, rikuperim dhe përballimin e avarive, të cilat janë thelbësore për garantimin e qëndrueshmërisë 24/7 të një platforme kritike si ajo e Portit të Durrësit. Po ashtu, ky profil profesional është i nevojshëm për realizimin e integriteteve të sakta dhe të qëndrueshme me sistemet aktuale të portit, si Oracle JDE, PCS, sistemet financiare dhe çdo aplikacion tjetër që kërkon sinkronizim të vazhdueshëm të të dhënave.

Këto kërkesa përbëjnë standard minimal profesional dhe teknologjik, të cilin nuk mund ta plotësojë personeli jo i certifikuar. Për rrjedhojë, parashikimi i detyrueshëm i një specialisti të certifikuar për bazën e të dhënave është plotësisht i justifikuar dhe garanton që zhvillimi dhe funksionimi i platformës së Portit Digjital të realizohet sipas standardeve më të larta ndërkombëtare, duke minimizuar çdo risk operacional dhe garantuar funksionim të sigurt, të saktë dhe të qëndrueshëm të sistemit.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- e) Te paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në Oracle Database Administrator, për integrimin e programeve web/mobile me databazat ekzistuese të institucionit. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklarimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Integrimi i platformës së Portit Digjital me databazat ekzistuese të institucionit kërkon domosdoshmërisht angazhimin e të paktën një specialisti të certifikuar në Oracle Database Administrator, pasi infrastruktura aktuale e të dhënave e Autoritetit Portual

Durrës bazohet kryesisht në teknologjinë Oracle dhe ndërvepron me sisteme kritike si Oracle JDE, PCS, modulët financiarë dhe shërbime të tjera operative. Certifikimi Oracle garanton që specialisti ka njohuritë dhe kompetencat e duhura për të siguruar integrim të sigurt, të saktë dhe të qëndrueshëm ndërmjet aplikacioneve të reja web/mobile dhe databazave aktuale.

Ky rol është thelbësor, sepse procesi i integritit përfshin konfigurime të ndërlikuara të skemave, optimizim të komunikimit midis aplikacioneve dhe databazës, menaxhim të lidhjeve (connection pooling), krijim të API-ve, procedurave të ruajtura dhe mekanizmeve të avancuar të kontrollit të aksesit. Vetëm një administrator i certifikuar Oracle është në gjendje të sigurojë që këto operacione kryhen sipas standardeve zyrtare të Oracle, duke garantuar integritetin e të dhënave, performancë të lartë në kushte ngarkese intensive dhe kompatibilitet të plotë me strukturat aktuale të institucionit.

Një person me certifikim Oracle kupton dhe aplikon në mënyrë korrekte praktikën e sigurta të zhvillimit dhe integritit, duke shmangur rreziqet që lidhen me query-t joefikase, konfigurimet e gabuara, problemet e transaksioneve dhe cenimin e sigurisë së të dhënave. Ai është i domosdoshëm edhe për menaxhimin e migrimëve, sinkronizimeve, auditimit dhe proceseve të rikuperimit në rast avarie, të cilat janë kritike për funksionimin 24/7 të platformave të portit.

Kërkesa për një specialist të certifikuar në Oracle Database Administrator nuk është vetëm kriter teknik, por një garanci e drejtpërdrejtë se integritet midis aplikacioneve web/mobile dhe databazave ekzistuese do të realizohen në mënyrë profesionale, të sigurt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të Oracle, duke mbrojtur stabilitetin e sistemeve të institucionit dhe cilësinë e shërbimit për përdoruesit.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- f) Të paktën 2 (dy) specialistë, të certifikuar për zhvillimin e programeve web/mobile me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Zhvillimi i platformës së Portit Digjital kërkon domosdoshmërisht angazhimin e të paktën dy specialistëve të certifikuar në zhvillimin e aplikacioneve web dhe mobile, pasi projekti përfshin një arkitekturë të ndërlikuar me module të shumta, integrimë të avancuara dhe volum të lartë funksionalitetesh që nuk mund të realizohen vetëm nga një individ. Këta specialistë duhet të kenë certifikime ose kualifikime ekuivalente në teknologjitë bashkëkohore të zhvillimit, me qëllim që platforma të ndërtohet duke respektuar standardet ndërkombëtare të cilësisë, sigurisë, performancës dhe shkallëzueshmërisë.

Përmasat e projektit, natyra kritike e operacioneve portuale dhe nevoja për të zhvilluar module të ndryshme si dhe shërbimet API, kërkojnë një ekip minimal prej dy zhvilluesish të specializuar që mund të punojnë paralelisht, të ndajnë përgjegjësitë sipas profileve (backend, frontend, mobile) dhe të sigurojnë vijimësi të punës gjatë gjithë fazave të projektit. Prania e të paktën dy specialistëve ofron stabilitet në zhvillim, shmang varësinë nga një person i vetëm, garanton mbulim të teknologjive të ndryshme dhe mundëson testim, verifikim dhe validim më të sigurt të kodit përpara vendosjes në prodhim.

Gjithashtu, zhvillimi i një platforme të tillë kërkon njohuri të thelluara në sigurinë kibernetike, në arkitektura moderne si microservices, në zhvillimin e API-ve, në performancën e aplikacioneve mobile dhe në UX/UI, të cilat nuk mund të mbulohen nga një specialist i vetëm. Dy zhvillues të certifikuar sigurojnë që standardet e kodimit, dokumentimit dhe mirëmbajtjes të respektohen, duke garantuar që platforma jo vetëm do të funksionojë siç duhet në momentin e dorëzimit, por edhe do të jetë e qëndrueshme dhe e shkallëzueshme në të ardhmen.

Kërkesa për të paktën dy specialistë të certifikuar për zhvillimin e programeve web/mobile përbën një kriter objektiv profesional dhe teknik, i domosdoshëm për të garantuar cilësi, siguri dhe besueshmëri të plotë në ndërtimin e platformes së Portit Digjital, si dhe për të siguruar një projekt të suksesshëm që respekton standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e institucionit.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

- g) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike me të cilën do të krijohet platforma e Portit digjital. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga**

deklarimet E_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet te jene te vlefshme. Nje person mund te disponoje nje ose me shume certifikime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Testimi i programeve kompjuterike përbën një fazë thelbësore të ciklit të zhvillimit të platformës së Portit Digjital, pasi nga cilësia e testimit varet stabiliteti, siguria dhe besueshmëria e sistemit që do të përdoret në operacionet kritike të portit. Për këtë arsye është e domosdoshme që ekipi i zhvillimit të përfshijë të paktën një specialist të certifikuar në testimin e programeve kompjuterike, i cili garanton që proceset e testimit kryhen sipas metodologjive dhe standardeve ndërkombëtare të njohura në industrinë e IT.

Ky specialist duhet të sigurojë që çdo modul i platformës – përfshirë funksionalitetet e aksesit, e-Parking, e-Leje, integrimet me PCS, NAVIS, JDE, portalet mobile dhe web, si dhe të gjitha komponentët API – të kontrollohen në mënyrë të pavarur, sistematike dhe profesionale, duke identifikuar gabimet, pasiguritë, defektet logjike dhe problemet e performancës përpara se sistemi të vendoset në përdorim. Duke qenë se Porti i Durrësit operon 24/7 dhe volumi i të dhënave e proceseve është shumë i lartë, një gabim i vogël në kod ose një funksionalitet i pa testuar siç duhet mund të shkaktojë ndërprerje të operacioneve, bllokime, humbje të të dhënave ose probleme sigurie.

Specialisti i certifikuar në testim sjell ekspertizë në teste funksionale, jo-funksionale, teste performance, teste sigurie, teste të ngarkesës dhe teste automatike, të cilat janë të domosdoshme për një platformë me kompleksitet të lartë si ajo e portit. Ai siguron që çdo modul i ri të verifikohet, validuar dhe dokumentuar saktë, duke garantuar që platforma të përputhet me kërkesat teknike, operacionale dhe të sigurisë së institucionit. Pavarësia profesionale që garanton certifikimi është gjithashtu e rëndësishme për të siguruar një proces objektiv testimi, të ndarë nga zhvillimi dhe i orientuar vetëm tek cilësia e produktit final.

Për këto arsye, kërkesa për të paktën një specialist të certifikuar për testimin e programeve kompjuterike përbën një kriter të domosdoshëm profesional dhe teknik, i cili siguron që platforma e Portit Digjital të jetë e qëndrueshme, e sigurt, funksionale dhe e besueshme në të gjitha fazat e përdorimit operacional.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021,I

ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë kërkesat aktuale për funksionalitet zgjerim cilësi e performancë si dhe shërbimet profesionale të kërkuara për teknologjite ekzistuese, ofrimit të produkteve të reja, karakteristikat e duhura bashkëkohore teknologjike, standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KOMISIONI: